

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BE planifikon të kufizojë aksesin në rrjetet sociale për personat nën 15 vjeç – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/be-planifikon-te-kufizoje-aksesin-ne-rrjetet-sociale-per-perso-nat-nen-15-vjec/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:14:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:12:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f47cf534ab76c00f5484199af5868fccf165592184eb4863341d5e668f889d09
TEKSTI	3319a595fb8fbe5881a5da32992d0db565f82fa1ab6dd36244fff67a7952b4ef
PAMJA	2c5d1b8ea61ec807da4118be1d6169325d71c73ed6d86b2a96c09bd44993220f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fbc56c7b9ed69046add555090305aedf7061137f5e86c9b1b6d23f122b147ced
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7da1a16455667271a66d1d30122b5a20135397a682b3b58f5cc074dfa4984ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fbc56c7b9ed69046add555090305aedf7061137f5e86c9b1b6d23f122b147ced>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Speciale: Demmi T'haçit, skandaloz

Sipas planeve, përdorimi i rrjeteve sociale nga fëmijët do të kufizohej në mënyrë graduale, duke përfshirë ndalimin e aksesit në platforma për fëmijët nën 13 vjeç.

Të moshës 13 deri në 15 vjeç do të mund të kenë akses në platforma vetëm për një orë në ditë, përmes “llogarive të vogla” të krijuara nëpërmjet llogarisë në rrjetet sociale të prindit ose kujdestarit të tyre.

Komisioni Evropian tha se kompanitë e rrjeteve sociale do të duhet të dëshmojnë se platformat e tyre janë të sigurta që në fazën e projektimit, ose do të përballen me gjoka deri në 6% të të ardhurave të tyre globale. Shefja e BE-së, Ursula von der Leyen, tha se kjo masë do t'i “rikthejë prindërit në vendin e drejtimit”.

Ajo shtoi se legjislacioni, i quajtur “EU Kids Act”, do t'u japë prindërve “mjetet për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të përballen me një botë më të sigurt”.

Kufizimet nuk do të prekin vetëm aplikacionet e njohura si TikTok, Instagram dhe Snapchat, por edhe YouTube dhe platforma të tjera të shpërndarjes së videove, si dhe chatbotët me inteligjencë artificiale dhe lojërat online.

“Shumë fëmijë po ekspozohen shumë herët ndaj një bote online, në të cilën ata nuk janë ende të gatshëm të orientojnë – një mjedis ku bullizmi mund të të ndjekë deri në shtëpi dhe ku çdo gabim mund të regjistrohet në rrjetet sociale”, tha von der Leyen.

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Sipas këtij ligji, vetëm fëmijët 15 vjeç e lart do të mund të krijojnë llogaritë e tyre në rrjetet sociale. Por von der Leyen u tha deputetëve të Parlamentit Evropian të enjten se “një kufi moshe nuk do të thotë t’i lëmë kompanitë e teknologjisë jashtë përgjegjësisë për përmbajtjen në platformë”.

Ajo shtoi se, nëse legjislacioni miratohet, kompanitë do të detyrohen të paraqesin plane të detajuara për sigurinë e fëmijëve.

“Për çdo person nën 18 vjeç, platformat duhet të ndjekin parimin e sigurisë që në projektim, pa funksione toksike apo varësie, pa kurthe dhe të tjera të ngjashme”, tha ajo.

Disa vende të BE-së kanë njoftuar tashmë planet e tyre për kufizimin e përdorimit të rrjeteve sociale nga fëmijët, përfshirë Francën dhe Spanjën.

Legjislacioni i propozuar në nivel të BE-së do t’i zëvendësonte këto masa dhe shtetet anëtare nuk do të mund të përjashtoheshin nga ajo që do të ishte një rregullore ligjërishme e detyrueshme.

Mësohet se Komisioni u ka paralajmëruar disa shtete anëtare se do të duhet të shfuqizojnë çdo ligj kombëtar të miratuar përpara hyrjes në fuqi të “EU Kids Act”.

Planet e reja duhet të miratohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe të marrin miratimin e Parlamentit Evropian.

Tashmë janë ngritur pyetje mbi mënyrën se si do të zbatohet kjo legjislacion në të gjithë BE-në dhe planet pritet të përballen me kundërshtime gjatë muajve në vijim. Franca tregon se rruga përpara mund të jetë e vështirë, pasi shtetet individuale anëtare mund të përpiqen t’i forcojnë ose t’i zbusin propozimet.

Qeveria e Macron hartoi legjislacion për ndalimin e rrjeteve sociale për personat nën 15 vjeç, por muajin e kaluar gjykata më e lartë e vendit e bllokoi atë, duke vendosur se cenonte lirinë e shprehjes.

Ministrat francezë kanë ndryshuar tashmë planet e tyre fillestare.

Disa kritikë të ndalimeve të rrjeteve sociale për fëmijët ngrenë shqetësime për privatësinë.

Ata shqetësohen se adoleshentët mund të detyrohen të dorëzojnë të dhëna personale gjatë procesit të verifikimit të moshës për të provuar se janë mjaftueshëm të rritur për të përdorur platformat.

Komisioni ka thënë se mosha do të verifikohet përmes aplikacionit ekzistues të BE-së për verifikimin e moshës dhe se nuk do të mblidhen apo shpërndahen të dhëna personale.

Kompanitë e rrjeteve sociale do të shprehin gjithashtu qëndrimin e tyre mbi këto kufizime, ndërsa akti do të debatohet gjatë muajve në vijim.

Von der Leyen kishte propozuar më parë një “shtyrje” të aksesit në rrjetet sociale për fëmijët në Evropë, duke thënë në maj se “diskutimi për një moshë minimale për rrjetet sociale nuk mund të injorohet më”. Politika, e paraqitur zyrtarisht të enjten, ishte paralajmëruar gjithashtu në fjalimin vjetor të shefes së BE-së të mërkurën. Në korrik, BE-ja tha se Meta duhet të ndryshojë dizajnin “varësues” të Facebook dhe Instagram, ose do të përballlet me një gjobë të rëndë.

Në gjetjet paraprake, Komisioni Evropian tha se funksione të tilla si lëvizja pa fund e përmbajtjes, videot që nisin automatikisht dhe rekomandimet e personalizuara mund të nxisin “përdorimin kompulsiv”, veçanërisht te fëmijët dhe adoleshentët.

Një zëdhënës i gjigantit të teknologjisë i tha BBC-së se nuk ishte dakord me këto gjetje, të cilat, sipas kompanisë, “nuk marrin parasysh në mënyrë të saktë hapat e rëndësishëm që kemi ndërmarrë për të mbrojtur adoleshentët”.

Në një çështje tjetër, Meta ra dakord në gusht për një marrëveshje prej 18 miliardë dollarësh (13.3 miliardë paund) me shtetet dhe territoret amerikane për të zgjidhur pretendimet se Facebook dhe Instagram u kanë shkaktuar dëm fëmijëve. Kompania mohoi çdo shkelje si pjesë e marrëveshjes.

Komisioni Evropian tha se legjislacioni i propozuar bazohet në gjetjet e panelit të tij të posaçëm për sigurinë e fëmijëve online, i cili rekomandoi rregullim të përshtatur sipas moshës, me udhëzime të ndryshme për çdo grupmoshë.

Ai iu referua gjithashtu të dhënave të një sondazhi të fundit të BE-së, sipas të cilit 92% e të anketuarve e konsideronin forcimin e mbrojtjes së fëmijëve online si një nga prioritetet kryesore të politikave. Von der Leyen tha se Komisioni kishte “parë nga Australia”, e cila vitin e kaluar ndaloi platformat e rrjeteve sociale për personat nën 16 vjeç, gjatë hartimit të propozimit.

Ndalimi ka qenë i vështirë për t’u zbatuar në Australi, ku ministrja e Komunikimeve, Anika Ells, pranoi në fillim të këtij muaji se deri tani asnjë kompani teknologjie nuk ishte gjobitur, pavarësisht kërtimeve që tregojnë se shumë persona nën 16 vjeç vazhdojnë të përdorin platformat.

Një ndalim i ngjashëm për personat nën 16 vjeç pritet të hyjë në fuqi në Mbretërinë e Bashkuar në pranverën e vitit të ardhshëm. /BBC/

#akses

#BE

#Rrjetetsociale

#VizionPlus



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

BOTA

Trump: Jemi drejt fundit të luftës me...

Xhuljana Zhuleku

27 minuta më parë

BOTA

Kongresi amerikan e miraton ligjin për...

Xhuljana Zhuleku

4 orë më parë

BOTA

Trump kërcënon Evropën me tarifa,...

Xhuljana Zhuleku

5 orë më parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale